

VENDIM
Nr.282, datë 16.4.2004

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujtitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Shkodrës, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:

a) zona e fushës së Mbishkodrës (SHK-1), që kullon me rrjedhje të lirë në liqenin e Shkodrës, me sipërfaqe 2500 ha;

b) zona e fushës së Mbishkodrës (SHK-2), që kullon me rrjedhje të lirë në lumin Kir, me sipërfaqe 2600 ha;

c) zona e fushës Oblikë-Ana e Malit (SHK-3), që kullon me rrjedhje të lirë në lumin Bunë, me sipërfaqe 1450 ha;

ç) zona e fushës së Zadrimes (SHK-4, SHK-5), që kullon me rrjedhje të lirë në lumin Drini i Vjetër dhe në lumin Gjadër, me sipërfaqe 3740 ha;

d) zona e fushës Nënshkodër-Trush (Shk-6), që kullon me rrjedhje të lirë në Vilun-Mertemzë, me sipërfaqe 9160 ha;

dh) zona e fushës së Velipojës (SHK-7), që kullon me ngritjen mekanike me hidrovor, me sipërfaqe 3200 ha;

e) zona e fushës Gruemirë-Koplik-Bajzë (MAK-1), që kullon me rrjedhje të lirë në liqenin e Shkodrës, me sipërfaqe 6510 ha;

ë) zona e fushës Bajzë-Koplik (MAK-2, MAK-3), që kullon me rrjedhje të lirë në liqenin e Shkodrës, me sipërfaqe 1890 ha;

f) pendët mbrojtëse nga përmytja e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

g) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano